

Në bazë të nenit 104, paragrafit (3) të Ligjit për Arsimin e Mesëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 229/20 dhe 78/25), ministria e Arsimit dhe Shkencës përcaktoi:

R R E G U L L O R E

për mënyrën e marrjes dhe shpërndarjes së mjeteve në shkollat e mesme publike

Neni 1

Me këtë Rregullore rregullohet mënyra e marrjes dhe shpërndarjes së mjeteve në shkollat e mesme publike (në tekstin e mëtejshmë: shkolla të mesme) nga pjesëmarrja e përdoruesve të shërbimeve dhe shitja e produkteve dhe shërbimeve që rrjedhin nga kryerja e aktiviteteve themelore dhe shtesë dhe nga shoqëritë tregtare, ndërmarrjet publike, institucionet dhe organet e administratës shtetërore, projektet e miratuara nga Ministri, donacionet, sponsorizimet, trashëgimitë, dhuratat, testamentet dhe burime të tjera në përputhje me ligjin.

Neni 2

Mjetet nga pjesëmarrja e përdoruesve të shërbimeve shkollat e mesme mund t'i marrin nga:

- arsimimi i nxënësve me korrespedencë;
- nënshtimi i provimeve të nxënësve me korresponcencë;
- arsimimi i nxënësve/pjesëmarrës në arsimin pas të mesëm;
- arsimimi i personave në arsimin joformal për të rritur;
- validimi i të nxënënit joformal dhe me përvojë (informal);
- diplomë, shtesë diplome, dëftesë, shtesë e dëftesës, certifikatë, shtesë e dëftesës të lëshuara nxënësve/pjesëmarrësve në arsimin e mesëm dhe personave në arsimin joformal etj.
- dokumentet e lëshuara: diplomë, shtesë diplome, deftesë, shtesë e dëftesës, certifikatë, shtesë e certifikatës etj;
- transkripte të vërtetimeve përfond të orëve.

Neni 3

Mjetet nga shitja e produkteve dhe shërbimeve që janë rezultat i kryerjes së aktiviteteve bazë dhe shtesë, shkollat mund të fitojnë nga:

- të ardhurat nga funksionimi i kompanive reale shkolllore;
- të ardhurat nga shitja e produkteve dhe shërbimeve nga kryerja e aktiviteteve bazë dhe shtesë të shkollës së mesme; dhe
- të ardhurat nga shërbimet përfundimtare e mjeteve dhe objekteve.

Neni 4

Mjetet nga kompanitë tregtare, ndërmarrjet publike, institucionet dhe organet e administratës shtetërore dhe personat fizik mund të sigurohen nga:

- projekte,
- donacione;
- sponsorizime;
- trashëgimi;
- dhurata;
- testamente dhe burime të tjera në përputhje me ligjin.

Neni 5

Mjetet e fituara në përputhje me nenet 2, 3 dhe 4 të kësaj Rregullore përdoren për avancimin modernizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve në shkollat e mesme, si dhe për nevoja të tjera të shkollave të mesme.

Neni 6

Shpërndarja e mjeteve të fituara në përputhje me nenet 2, 3 dhe 4 të kësaj Rregullore është si vijon:

- 1) Një pjesë e mjeteve në lartësi deri në 50% përdoren për qëllimet e mëposhtme:
 - furnizimin me mjetet didaktike, pajisje dhe materiale për nevojat e shkollës;
 - furnizimin me pajisje TIK;
 - furnizimi i pajisjeve, veglave dhe makinave për arsim praktik dhe për nevojat e shkollës;
 - furnizimi i materialeve për realizimin e arsimit praktik dhe për nevojat e shkollës;
 - mirëmbajtja e hapsirave dhe klasave për mësimdhënie, si dhe ambienteve të tjera shkollore dhe oborrit të shkollës;
 - mirëmbajtja e pajisjeve ekzistuese në shkollë;
 - furnizimi me inventar të vogël dhe materiale të tjera;
 - furnizimi me mjetet për sigurinë në punë të nxënësve, mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë;
 - pasurimin e koleksionit të bibliotekës;
 - trajnimin dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë;
 - pjesëmarrjen në garat vendase dhe ndërkombëtare të nxënësve dhe mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë;
 - arsimim praktik i nxënësve në shkolla të tjera partnere në vend dhe jashtë vendit;
 - vizita në kompani, panaire, seminare, forume dhe konferanca të nxënësve dhe mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë në shërbim të sektorit në vend dhe jashtë vendit; dhe
 - kërkime në fushën e arsimit.

- 2) Një pjesë e mjeteve në lartësi deri në 20%, përdoren për të siguruar kushte për investime të reja për të përmirësuar kushtet hapësinore dhe kushtet e tjera të punës në shkollë.
- 3) Një pjesë e mjeteve deri në 30%, përdoret për angazhimin e punonjësve të shkollës së mesme dhe personel të jashtëm që nuk janë të punësuar në shkollë.

Neni 7

Punonjësit nga neni 6, paragrafi (1), pika (3) angazhohen për detyra pune jashtë orarit të rregullt të punës ose për detyra pune që nuk janë të përcaktuara për pozicionin e tyre të punës me aktin për sistematizimin e shkollës së mesme.

Personat e jashtëm që nuk janë të punësuar nga shkolla angazhohen sipas nevojës dhe sipas vlerësimit të drejtorit të shkollës së mesme.

Lartësia e kompensimit rregullohet me akt të brendshëm të miratuar nga këshilli shkollor i shkollës së mesme.

Për angazhimin nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni, drejtori i shkollës së mesme sjell akt (aktvendim ose vendim).

Si përjashtim nga paragrafi (4) i këtij neni, nëse drejtori i shkollës së mesme është i angazhuar, akti për të sjellët nga kryetari i Këshilli të shkollës.

Në shkollat e mesme, duhet të mbahen të dhëna për aktet e përmendura në paragrafin (4) dhe (5) të këtij neni.

Punonjësi ose personi i angazhuar i përmendur në paragrafin (1) dhe (2) përgatitet Raport për angazhimin, i cili do të miratohet nga drejtori i shkollës së mesme, dhe nëse drejtori i shkollës së mesme është i angazhuar, Raporti i angazhimit do të miratohet nga kryetari i Këshillit të Shkollës.

Neni 8

Një pjesë e mjeteve të fituara në përputhje me nenin 2, 3 dhe 4 të kësaj Rregulloreje mund të përdoret edhe për pagesën e pagave të personelit mësimor dhe personelit tjetër në shkollat e mesme, të cilët kanë themeluar marrëdhënie pune në procedurë në përputhje me rregulloret pozitive në Republikën e Maqedonisë së Veriut në fushën e punësimit, si dhe për angazhimin e personave me kontratë në vepër në përputhje me Ligjin për Transformim në Marrëdhënie të Rregullt Pune.

Nëse shkolla e mesme ka punësuar ose angazhuar kuadër mësimor dhe kuadër tjetër nga paragrafi 1 i këtij neni, nga totali i mjeteve të fituara në përputhje me nenin 2, 3 dhe 4 të kësaj Rregulloreje, së pari paguhën mjetet për paga nga paragrafi (1) i këtij neni, dhe mjetet e tjera përdoren në përqindje në përputhje me nenin 6 të kësaj Rregulloreje.

Neni 9

Si përjashtim nga neni 6 i kësaj Rregulloreje, shkollat e mesme mund të përdorin shumë mbi përqindjen e përcaktuar me pëlqimin paraprak nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për shkollat e mesme shtetërore, gjegjësisht nga kryetari i komunës /Qytetit të Shkupit për shkollat e mesme komunale/shkollat e mesme të qytetit të Shkupit.

Neni 10

Shkollat e mesme të përmendura në nenin (1) të kësaj Rregulloreje, më së voni deri më 28 shkurt të viti vijues për vitin paraprak, duhet të parashtrojnë Raport për marrjen dhe shpërndarjen e mjeteve edhe atë: shkollat e mesme shtetërore në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, shkollat e mesme komunale te kryetari i Komunës në territorin e së cilës ndodhen edhe shkollat e mesme të qytetit të Shkupit te Kryetari i Qytetit të Shkupit.

Neni 11

Për mjetet nga pjesëmarrja e përdoruesve të shërbimeve në përputhje me nenin 2 të kësaj Rregulloreje, Këshilli i shkollës së mesme sjell Listë Çmimesh.

Për shitjen e produkteve dhe shërbimeve që janë rezultat i kryerjes së aktivitetit kryesor në përputhje me nenin 3 të këtyre Rregulloreve, Këshilli i shkollor i shkollës së mesme sjell Listë Çmimesh më së voni deri më 1 gusht në vitin shkollor vijues për vitin shkollor pasardhës.

Lista e çmimeve të përmendura në paragrafin (2) të këtij neni mund të plotësohet, ose ndryshohet nga Këshilli i shkollës edhe gjatë vittit, nëse bëhet fjalë për karakter sezonal të prodhimit dhe shitjes së produkteve.

Neni 12

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, pushon së vlefshmi mënyra e fitimit dhe shpërndarjes së mjeteve në shkollat e mesme publike me numrin prot.20-17268/1 të datës 30.12.2016.

Procedurat e filluara me Rregulloren për mënyrën e marrjes dhe shpërndarjes së mjeteve në shkollat e mesme publike me numër prot.20-17268/1 të datës 30.12.2016, përfundojnë me dispozitat e të njëjtës rregullore.

Neni 13

Kjo Rregullore hyn në fuqi nga dita e nesërme e sjelljes së saj.

Numër 13-8277/1

_____.06.2025

Shkup

Министерка за образование и наука,
Ministre e Arsimit dhe Shkencës,
проф. д-р Весна Јаневска, с.р.